



VENDIMIN

Nr. 26 Datë 02.03.2012

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “HYDRO SALILLARI” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, neneve 9 dhe 13 pikat 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 gërma “g”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 02.03.2012, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “HYDRO SALILLARI” sh.p.k si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HYDRO SALILLARI” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “HYDRO SALILLARI” sh.p.k në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI